



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 8967/4338/2062

Nr. Vendimit 2605

Data e regjistrimit 04.11.2014

Data e vendimit 15.09.2016

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ	Kryesuese
Amarildo LAÇI	Anëtar
Bari SHYTI	Anëtar

me sekretare gjyqësore [REDACTED] në Tiranë, sot në datë 15.09.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

PADITES: *Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi"*

I PADITUR: *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*

PERSON I TRETË: [REDACTED], i biri i [REDACTED], i dtl
[REDACTED] lindur e banues në [REDACTED]

OBJEKTI: -Shfuqizimi i aktit administrativ vendimit nr. 75, datë 01.07.2013 "Për dënimin me jobë" dalë në zbatim të vendimit nr. 28, datë 04.04.2013 të palës së paditur.

-Sigurimin e padisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32/a, 202, 324/a, 325, 329 të K.Pr.Civile. Nenet 107, 108, 109, 115/a, 116/c, 117/1/2, 331 të K.Pr.Administrative. Konventa në kuadër të Mbrojtjes së Pakicave Kombëtare, nenet 11, 20. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 10, 11, 14. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, nenet 1, 2, 3 dhe neni 34 e vijues i këtij ligji.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoi relacionin e kryesueses së trupit gjykues dhe bisedoi çështjen në tërësi:

VËREN

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.11.2014 është regjistruar ankimi i paraqitur nga pala paditëse subjekti politik "Aleanca Kuq e Zi" kundër vendimit nr. 2337, datë 13.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenet 442, 443 të K.Pr.Civile dhe nenin 48 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Ky ankim është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 21.05.2014. Kjo gjykatë me vendimin e datës 21.05.2014 ka vendosur pranimin e ankimit duke dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit, ankimin së bashku me aktet e njoftimit të tij, si dhe dosjen e gjykimin për shqyrtim.

Nga aktet e dosjes së gjykimin rezulton se në datën 16.07.2013, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, me padinë objekt gjykimi. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 1742, datë 07.02.2014 ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe tokësore për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e saj për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo gjykatë me vendimin nr. 2337, datë 13.05.2014, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi" i paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga

Diskriminimi, person i tretë [REDACTED] dhe objekt Shfuqizimi i aktit administrativ vendimit nr. 75, datë 01.07.2013 "Për dënimin me gjobë" dalë në zbatim të vendimit nr. 28, datë 04.04.2013 të palës së paditur, si të pabazuar në ligj dhe në prova"

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi" duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Vendimi i gjykatës është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile dhe legjislacionin administrativ në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe me parimet e përcaktuara në të.
- ✓ Pretendimet e ngritura nga pala e paditur dhe personi i tretë janë sa absurde aq edhe jo reale, pasi nga ana e subjektit politik "Aleanca Kuq e Zi" në Komunën Liqenas, nuk është ndërmarrë asnjë veprim diskriminues apo dhunues kundrejt përfaqësuesve dhe komunitetit të Liqenasit.
- ✓ Akti administrativ vendimi nr. 75, datë 01.07.2013 i nxjerrë në zbatim të vendimit nr. 28, datë 04.04.2013, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi është marrë në kundërshtim me formën dhe procedurën ligjore të kërkuar nga ligji, çka ka sjellë në këtë mënyrë cenimin e interesave të paditësit.
- ✓ Me nxjerrjen aktit administrativ vendimit nr. 75, datë 01.07.2013, dal në zbatim të vendimit nr. 28, datë 04.04.2013, konstatojmë se nuk janë përmbushur një sërë kriteresh të caktuara si të detyrueshme nga legjislatori, për tu zbatuar. Pra ky urdhër nuk e ka ndjekur procedurën ligjore, procedurë kjo e cila përshkruhet në detaje, në K.Pr.Administrative.
- ✓ Vendimi nr. 75, datë 01.07.2013, dal në zbatim të vendimit nr. 28, datë 04.04.2013 nga pala e paditur prek të drejtat dhe interesat e paditësit, e në këtë rast, arsyetimi i tij duhet që të ishte i detyrueshëm, fakt ky i pakontestueshëm, pasi ky veprim nuk është kryer nga ana e këtij organi, e për rrjedhojë mospërmbushja e këtij detyrimi, si dhe një sërë detyrimesh ligjore të tjera, ka sjellë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ në fjalë.
- ✓ Ky akt konsiderohet si një akt administrativ i pavlefshëm, e për rrjedhojë nuk mund të prodhojë pasoja ligjore, në referim të nenit 117, pika 1 të K.Pr.Administrative.
- ✓ Për sa i përket pretendimit se nga ana e subjektit politik Aleanca Kuq e Zi ka pasur

diskriminim, sqarojmë se referuar Konventës në Kuadër të Mbrojtjes së Pakicave Kombëtare nenet 11 e 20, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nenet 10, 11, 14, ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, neneve 1, 2, 3, 14, 18 të Kushtetutës nuk ndodhemi përpara diskriminimit.

- ✓ Nga ana e subjektit politik në asnjë moment nuk është dhunuar asnjë nga institucionet e Komunës Liqenas të përmendura në ankesën e z[REDACTED], si dhe në asnjë moment nuk janë kërcënuar banoret e minoritetit Maqedonas.
- ✓ Subjekti politik ka kryer vetëm një detyrë të cilën e ka pasur në ngarkim Shteti Shqiptar. Kjo detyrë ka qenë vendosja e gjuhës shqipe në tabelat e Komunës së Liqenasit, veprim ky i cili është kryer në mënyrën më të mirë paqësore, pa i dëmtuar aspak sinjalistikat e Komunës së Liqenasit si dhe pa kërcënuar në asnjë moment banorët e minoritetit Maqedonas.
- ✓ Duke ju referuar nenit 20 të Konventës Kuadër Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, konstatojmë sërish se mos përdorimi i gjuhës SHQIPE në institucionet dhe tabelat e sinjalistikës së Komunës Liqenas, bie në kundërshtim me Konventën Kuadër Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Mosrespektimi i kësaj dispozite sjell rrjedhimisht edhe shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- ✓ Nga ana e subjektit politik Aleanca Kuq e Zi nuk është bërë asgjë më shumë sesa është shprehur shqetësimi për mospërdorimin e Gjuhës Amtare Shqiptare, mbi trojet Shqiptare, të Komunës së Liqenasit. Ky shqetësim i ngritur nga ana e subjektit politik Aleanca Kuq e Zi, është një e drejtë e cila buron drejtpërdrejtë nga Konventa e sipërcituar, mbi bazën e të cilës kanë dalë dhe zbatohen një shumëllojshmëri aktesh të tjera.
- ✓ Në zbatim të nenit 11 të Konventës si dhe fakteve mediatike konstatohet fare qartë se tubimi i kryer nga subjekti politik "Aleanca Kuq e Zi", në Komunën e Liqenasit është një tubim i kryer në mënyrë paqësore duke përmbushur kriterin thelbësor të përcaktuar në nenin 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- ✓ Në interpretim të pikës 2 të nenit 11 të kësaj dispozite konstatohet fare qarte se tubimi paqësor i kryer nga subjekti politik "Aleanca Kuq e Zi", në Komunën e Liqenasit është kryer në interes të sigurisë kombëtare, të trojeve dhe gjuhës Shqiptare.
- ✓ Në zbatim të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga ana e subjektit politik "Aleanca Kuq e Zi" nuk është kryer asnjë veprim diskriminues e as është shprehur

asnjë thënie apo fjali diskriminuese për komunitetin e Liqenasit.

- ✓ Në lidhje me pretendimin e diskriminimit në zbatim të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, nga ana e Komunës së Liqenasit nuk është respektuar parimi i barazisë siç përcaktohet edhe në nenin 1 dhe 2 të po këtij ligji. Kjo pasi nga ana e kësaj Komune në të gjitha institucionet dhe sinjalistikat e saj nuk ishte e shkruar gjuha amtare Shqipe, por vetëm gjuha Maqedonase.
- ✓ Konstatohet se nuk ndodhemi përpara rastit të diskriminimit pasi nga ana e subjektit politik Aleanca Kuq e Zi nuk është kërkuar nga ana e Komunës së Liqenasit apo komunitetit të saj, përjashtimi, kufizimi apo ndonjë preferencë e saj e cila mund të cënonte këtë komunitet, por nga ana e Subjektit Politik Aleanca Kuq e Zi, është kërkuar respektimi i parimit të barazisë së përdorimit të Gjuhës Amtare Shqipe, pasi në këtë komunitet përdoret vetëm gjuha Maqedonase.

Për sa më sipër pala paditëse Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi" ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 2337, datë 13.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë.

Parashtrimi i rrethanave të faktit

Pala paditëse Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi" ka organizuar një aktivitet në Komunën Liqenas të Qarkut të Korçës. Pas ankesës së Kryetarit të Komunës Liqenas, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me urdhrin nr. 2, datë 14.01.2013 ka urdhëruar drejtorinë e Hetim-Inspektimit të kryejë një inspektim në Komunën Liqenas të Qarkut të Korçës. Sipas procesverbalit të datës 16.01.2013 ora 16.00 konstatohet se nga veprimet e kryera nga aktivistët e Subjektit Politik "Aleanca Kuq e Zi" dhe deklaratat e tyre përbëjnë diskriminim në gëzimin e të drejtave të garantuara nga legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar.

Me vendimin nr. 28, datë 04.04.2013 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar se qëndrimet dhe deklaratat e palës paditëse përbëjnë diskriminim dhe ka detyruar subjektin politik "Aleanca Kuq e Zi" të kërkojë falje publike dhe të evitojë në të ardhmen qëndrimet që nxisin dhunën dhe forma të tjera diskriminuese ndaj pakicave kombëtare. Në këtë vendim palës

paditëse i është lënë një afat kohor 30 ditor për të njoftuar Komisionerin në lidhje me veprimet e marra për zbatimin e vendimit. Kundër këtij vendimi Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi" më datë 02.05.2013 ka depozituar ankim në të cilin ka parashtruar edhe shkaqet e kundërshtimit të këtij vendimi. Me shkresën nr. 355 prot., datë 14.06.2013 Komisioneri i ka bërë me dije palës paditëse se në bazë të ligjit Komisionerit nuk i njihet e drejta për të revokuar aktin duke i rikujtuar se ishte në detyrimin e subjektit politik "Aleanca Kuq e Zi" që në referim të nenit 33/11 të zbatonte vendimin nr. 28, datë 04.04.2013.

Duke qenë se pala paditëse nuk i ka përmbushur detyrimet sipas vendimit, me vendimin nr. 75, datë 01.07.2013 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka gjobitur palën paditëse në shumën [REDAKTUAR] lekë duke i përcaktuar edhe afatin e derdhjes së kësaj shume në buxhetin e shtetit brenda datës 02.08.2013. Duke mos qenë dakord me këtë vendim pala paditëse Subjekti Politik "Aleanca Kuq e Zi" i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi duke pretenduar se ky akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm dhe ka kërkuar shfuqizimin e tij.

Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit

Së pari Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 germa "a", nenit 10 paragrafi 2 germa "a" dhe nenit 44 të ligjit nr. 49/2012, kjo Gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se ankimi nuk është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" dhe për këtë arsye duhet vendosur mospranimi i tij për shqyrtim për këto arsye:

Nga rrethanat e çështjes konstatohet se pala paditëse kërkon me padinë objekt gjykimi, kundërshtimin e vendimit "Për dënim me gjobë" nr. 75, datë 01.07.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Konstatohet se akti administrativ objekt kundërshtimi përmban detyrimin e palës paditëse për pagimin e gjobës, shumës në të holla, konkretisht prej [REDAKTUAR] lekë.

Referuar nenit 45 germa "b" të ligjit nr. 49/2012 në të cilin përcaktohet se: "*Nuk lejohet ankimi ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundravajtjes administrative me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi*", konstatohet se një nga kushtet e pranueshmërisë së ankimit është edhe vlera e detyrimit në të holla që përmban akti i kundërshtuar.

Paga minimale në shkallë vendi rezulton të jetë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 03.07.2013. Në pikën 1 të këtij vendimi është përcaktuar se "*Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas a i huaj, të jetë 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë.*" Duke llogaritur njëzetfishin e kësaj page, konstatohet vlera 440.000 (katërqind e dyzet mijë) leke. Kjo shumë përbën kufirin minimal të detyrimit në të holla që duhet të përmbajë akti administrativ objekt kundërshtimi në gjykatën administrative, që të legjitimohen palët ndërgjyqëse në paraqitjen e ankimit kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në rastin në shqyrtim detyrimi në të holla që përmban akti objekt kundërshtimi, është dukshëm më i vogël se shuma e lejuar prej 440.000 lekë. Sipas germës "a" të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos: "*mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë*". Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit, duke vlerësuar se nuk plotësohet një prej kushteve të pranueshmërisë së ankimit, referuar nenit 50 germa "a" të ligjit nr. 49/2012 duhet të vendose mospranimin e ankimit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, germa "a" të ligjit nr. 49/2012 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*".

VENDOSI

Mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. 2337, datë 13.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë më 15.09.2016

ANËTAR
Amarildo LAÇI
dv

ANËTAR
Bari SHYTI
dv

KRYESUESE
Lindita SINANAJ
dv

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelati
Leonard Shyti
Bari Shyti